



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALËSI E MADHE
KËSHILLI

Koplik më: 26/05/2022

V E N D I M

Nr 16, Datë 26 / 04 / 2022

PËR

**MIRATIMIN E DHËNIES ME QIRA/NE PËRDORIM TË SIPERFAQES PYJORE PËR
NDËRTIMIN E LINJES SË UJIT PËR OBJEKTIN "FABRIKË PËR AMBALLAZHIMIN NË
SHISHE OSE ENË DHE PRODHIMIN E LËNGJEVE" NGA SHOQERIA "CANAJ" Sh.P.K DHE
HEQJEN NGA FONDI PYJOR I SIPËRFAQES QË PËRSHKOHET NGA LINJAT E DËRGIMIT
TË UJIT TEK LINJA E PRODHIMIT TË SUBJEKTIT, MBI LUMIN E CEMIT
TAMARE,NJËSIA ADMINISTRATIVE KELMËND.**

Këshilli Bashkiak Malësi e Madhe, në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" neni 54 pika "e/1", ligjin nr.48/2016 "Për disa ndryshime dhe shtesa me ligjin 9385 datë 04.05.2005" Për pyjet dhe Shërbimin Pyjor", si dhe VKM nr.1353 dt.10.10.2008 i ndryshuar "Për rregullat për paraqitjen e kërkeses,mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik,kriteret dhe procedurat e zvogëlimit të sipërfaqes dhe të vëllimit të fondit pyjor",VKM nr.1374 10.10.2008 të ndryshuar "Për rregullat dhe procedurat që ndiqen për heqjen,shtimin dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kullor",Udhëzimi e Ministrit Të Mjedisit nr.1 dt.09.06.2016 "Për rregullat ,procedurat e kërkimit ,të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullor publik" . VKM nr.1064 dt.22.12.2010 "Për disa ndryshime në vendimin nr.391 dt.21.06.2006 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave",si dhe bazuar në VKM. 684, datë 02.09.2020 "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin Nr.433, datë 08.06.2016 , të Këshillit të Ministrave, "Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike ,sipas listave të inventarit , dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish Komunave /Bashkive ", të ndryshuar.

VENDOSI:

1. Dhënie me qira /në përdorim të sipërfaqes pyjore 0.5239 ha që shtrihen në ngastrat sipas tabelës bashkangjitur raportin mbi studimin tekniko ekonomik të hartuar nga Drejtoria e Administrimit të Pyjeve, për një afat 10 (dhjetë) vjeçar.
2. Vlera totale e dhëniës me qira është 301 585 (treqindënjëmijëepesëqindetëdhjetëepesë)lekç/vit.

3. Vlerën e investimeve që do të kryhen (pyllëzime, zëvendësime, përmirësime, etj.) për sipërfaqen që do të zëvendësoj sipërfaqen e hequr nga fondi pyjor e kullosor për 0.0665 Ha = 105 725 Leke, shume e cila do të paguhet vetëm vitin e parë të lidhjes së kontratës.
4. Për zbatim të këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë Malësi e Madhe.
5. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55 pika 6 të ligjit nr. 139/2015 "Për Veteqeverisjen Vendore".

KRYETAR

Ilir Hala

SEKRETAR

Emirjan Hasmuja

Miratur me 26.04.2022

Vota Pro 22

Vota Kunder 0

Vota Abstenim 0

Zbardhur me datë 28.04.2022